Agjencia Kombëtare e Kontrollit të Cannabis-it

BULETIN 04

BULETIN

SHTATOR- TETOR 2026

PËRMBAJTJA

01 Nga bima tek produkti: gjurmueshmëria në çdo fazë

02 Mbikëqyrja e *cannabis*-it hyn në një fazë të re

03 Bashkëpunim ndërinstitucional për Kapitullin 24, “Drejtësia, Liria dhe Siguria”

04 Agjencia Kombëtare e Kontrollit të *Cannabis*-it në “Cultiva HANFEXPO Vienna 2026”

05 Tetori Rozë: Kontrolli është dashuri më vete

06 Aktivitetet e Agjencisë në rrjetet sociale

07 Njihuni me stafin e Agjencisë

NGA BIMA TEK PRODUKTI: GJURMUESHMËRIA NË ÇDO FAZË

Më 6 tetor 2026 Agjencia zhvilloi një takim teknik online me përfaqësues të shoqërisë ALBTrace. Në këtë takim prezantimi u fokusua në funksionalitetet e sistemit për gjurmimin e produktit përgjatë gjithë ciklit të tij.

Agjencia Kombëtare e Kontrollit të *Cannabis*-it (AKKC) po vijon punën për vënien në zbatim të sistemit elektronik të gjurmueshmërisë (track-and-trace) të bimës së *cannabis*-it dhe nënprodukteve të saj, në përputhje me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi.

Agjencia dhe ALBTrace do të vijojnë punën për vlerësimin e kërkesave dhe përshtatjen e sistemit, duke përcaktuar hapat e mëtejshëm të implementimit dhe duke synuar përgatitjen e tij në kohë për procesin e licencimit.

Sistemi siguron gjithashtu funksione që mbështesin kontrollin, mbikëqyrjen dhe inspektimin, dhe monitorimin të të dhënave dhe të licencensuarve si dhe operatorëve në treg.

Ky bashkëpunim përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt ndërtimit të një sistemi kombëtar të besueshëm, transparent dhe në përputhje me standardet evropiane për kontrollin e *cannabis*-it.

Lexo më shumë...

MBIKËQYRJA E *CANNABIS*-IT HYN NË NJË FAZË TË RE

Vendimi 748

"Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për mbikëqyrjen e veprimtarive të licencuara dhe të lejuara me bimën e *cannabis*-it dhe prodhimit të nënprodukteve të saj për qëllime mjekësore dhe industriale."



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I MINISTRAVE

Këshilli i Ministrave miratoi, në mbledhjen e datës 2 tetor 2026, vendimin që përcakton rregullat e hollësishme për mbikëqyrjen, kontrollin dhe inspektimin e subjekteve dhe veprimtarive të licencuara apo të lejuara për bimën e *cannabis*-it, nënproduktet dhe produktet e saj për qëllime mjekësore dhe industriale.

Agjencia Kombëtare e Kontrollit të *Cannabis*-it do të ushtroj mbikëqyrje përgjatë gjithë ciklit të aktivitetit të subjektit, në terren dhe në distancë përmes mjeteve të autorizuara me teknologji të avancuar të cilat mundësojnë akses të pandërprerë 24/7. si dhe do të koordinoj kontrollet dhe inspektimet nga autoritetet e tjera kompetente.

Gjurmueshmëria e materialit do të shtrihet nga importi dhe kultivimi, përpunimi, ruajtja dhe transporti, deri te eksporti ose asgjësimi. Çdo lot, material apo produkt do të identifikohet dhe regjistrohet.

Kontrolli i cilësisë do të mbështetet në marrjen dhe analizimin e mostrave, veçanërisht kur vlera e matur e THC-së në *cannabis*-in industrial tejkalon kufirin maksimal të lejuar prej 0.8%, sipas ligjit nr. 61/2023.

Lexo më shumë...

BASHKËPUNIM NDËRINSTITUCIONAL PËR KAPITULLIN 24, “DREJTËSIA, LIRIA DHE SIGURIA”

Kapitulli 24

Drejtësia, Liria dhe Siguria



Në kuadër të procesit të integrimit evropian, institucionet shqiptare vijojnë angazhimin e përbashkët për përmbushjen e angazhimeve të përcaktuara në Kapitullin 24, “Drejtësia, Liria dhe Siguria,” me fokus të veçantë në Closing Benchmarks.

Më 30 shtator 2026, u zhvillua takimi vijues i Grupit Ndërinstitucional të Punës për Kapitullin 24, ku morën pjesë përfaqësues të institucioneve përgjegjëse dhe kontribuese në këtë proces.

Takimi u përqendrua në ecurinë e masave të përcaktuara në Closing Benchmarks, afatet dhe përgjegjësitë përkatëse, me synim konsolidimin e një qasjeje të unifikuar mbi pikat përmbyllëse dhe masat konkrete, si dhe koordinimin e hapave të mëtejshëm për vijimin e procesit.

Agjencia Kombëtare e Kontrollit të *Cannabis*-it është pjesë aktive e këtij procesi, duke dhënë kontributin e saj në përputhje me përgjegjësitë dhe kompetencat institucionale, në lidhje me masat dhe angazhimet përkatëse të Kapitullit 24, si dhe në mbështetjen e procesit të integrimit evropian.

Bashkërendimi i vazhdueshëm ndërmjet institucioneve dhe puna e përbashkët për Closing Benchmarks mbeten të rëndësishëm për konsolidimin e angazhimeve dhe vijimin e procesit të integrimit evropian.

AGJENCIA KOMBËTARE E KONTROLLIT TË *CANNABIS*-IT NË "CULTIVA HANFEXPO VIENNA 2026"

Përfaqësues të Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të *Cannabis*-it morën pjesë në aktivitetin ndërkombëtar "Cultiva HANFEXPO Vienna 2026", të zhvilluar në Vienë, Austri, me fokus njohjen e zhvillimeve teknologjike dhe praktikave ndërkombëtare në fushën e *cannabis*-it.



Gjatë aktivitetit, u zhvilluan takime me përfaqësues të subjekteve dhe organizatave që veprojnë në sektor.



Diskutimet u përqendruan në teknologjitë e kultivimit në mjedise të hapura dhe të mbuluara, sistemet hidroponike, substratet biologjike, pajisjet për përpunimin pas vjeljes, teknologjitë e ekstraktimit dhe filtrimit, si dhe zgjidhjet për ambalazhimin dhe ruajtjen e cilësisë së produktit.

Paralelisht me panairin, u zhvillua "Cultiva Congress 2026", me një program të orientuar drejt çështjeve shkencore, mjekësore, ligjore dhe teknike. Sesionet trajtuan përdorimin e *cannabis*-it mjekësor në praktikën klinike, legjislacionin për substancat e kontrolluara, kërkimet mbi format e konsumimit, shumimin përmes kulturës së indeve dhe optimizimin e proceseve pas vjeljes.

Pjesëmarrja në këtë aktivitet kontribuon në forcimin e kapaciteteve institucionale të Agjencisë dhe në përmirësimin e proceseve të licencimit, mbikëqyrjes, kontrollit, inspektimit dhe gjurmueshmërisë së veprimtarive të lidhura me *cannabis*-in për qëllime mjekësore dhe industriale.

TETORI ROZË: KONTROLLI ËSHTË DASHURI PËR VETEN



Tetori Rozë është një kujtesë për rëndësinë e ndërgjegjësimit, kujdesit për shëndetin dhe diagnostikimit të hershëm.

Stafi i Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të *Cannabis*-it, në bashkëpunim me Institutin e Shëndetit Publik (ISHP), organizoi në ambientet e Agjencisë një sesion informues dhe ndërgjegjësues në kuadër të Tetorit Rozë, muajit të ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit.







Aktiviteti synoi të nxiste informimin dhe ndërgjegjësimin mbi rolin e parandalimit dhe të kujdesit të vazhdueshëm për shëndetin.

Përmes këtij aktiviteti, Agjencia rithekson rëndësinë e promovimit të shëndetit dhe të nxitjes së një kulture ndërgjegjësimi, duke vënë theksin te mesazhi se diagnostikimi i hershëm dhe kujdesi për veten mund të bëjnë diferencën.

Lexo më shumë...


AKTIVITETET E AGJENCISË NË RRJETE SOCIALE











Në vijën e parë të mbikëqyrjes

Standardet që zbatohen në veprimtaritë e licencuara të *cannabis*-it mjekësor


Subjektet e licencuara janë të detyruara të zbatojnë standardet dhe kërkesat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për *cannabis*-in për qëllime mjekësore.
Agjencia Kombëtare e Kontrollit të *Cannabis*-it mbikëqyr dhe verifikon zbatimin e këtyre standardeve nëpërmjet proceseve të inspektimit, kontrollit dhe monitorimit.


Kush jemi?

Agjencia Kombëtare e Kontrollit të *Cannabis*-it është institucioni përgjegjës për mbikëqyrjen, kontrollin dhe inspektimin e veprimtarive të *cannabis*-it për qëllime mjekësore dhe industriale në Republikën e Shqipërisë.

04

TEKNOLOGJITË TRADICIONALE TË PËRPUNIMIT





NJIHUNI ME STAFIN E AGJENCISË



Farmaciste me përvojë disa vjeçare pranë Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, në vlerësimin dhe verifikimin e dokumentacionit shoqërues për importin dhe eksportin e barnave, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Aktualisht, ushtron detyrën e specialistes pranë Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të *Cannabis*-it, ku angazhohet në veprimtaritë që lidhen me mbikëqyrjen, kontrollin dhe inspektimin e subjekteve të lejuara.

Anjeza Saliaj

> *“Kur shkenca farmaceutike ndërthuret me potencialin e natyrës, një bime e njohur prej shekujsh mund të vlerësohet në aspekt të ri shkencor dhe terapeutik.”*

NJIHUNI ME STAFIN E AGJENCISË



Desantila Qafa është inxhiniere mjedisi, e diplomuar në programin Master i Shkencave me profil Energjitikë në Universitetin Politeknik të Tiranës. Ajo ka mbi 10 vjet përvojë profesionale në auditimin e sistemeve të menaxhimit dhe vlerësimin e përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare. Aktualisht, ushtron detyrën e Koordinatores pranë Agjencisë Kombëtare të Kontrollit të *Cannabis*-it, ku angazhohet në koordinimin e veprimtarive të mbikëqyrjes, kontrollit dhe inspektimit, zhvillimin e metodologjive të punës, si dhe monitorimin e zbatimit të kërkesave ligjore për cannabis-in industrial.

Desantila Qafa

> *“Në një sektor në zhvillim si ai i cannabis-it industrial, besoj se qartësia rregullatore, përgjegjësia institucionale dhe praktikat e mira janë thelbësore për një sistem efektiv mbikëqyrjeje. Suksesi qëndron tek aftësia për t’i kthyer kërkesat ligjore dhe standardet në procese konkrete, të zbatueshme dhe të matshme.”*

NJIHUNI ME STAFIN E AGJENCISË



Irina Argjiri është farmaciste dhe doktorante pranë Universitetit të Mjekësisë, Tiranë. Përvoja e saj ndërthur punën pas banakut të farmacisë me kërkimin shkencor, kontrollin e cilësisë në industrinë e prodhimit të barnave dhe së fundmi, me kontrollin rregullator.

Në rolin aktual pranë Agjencisë, vlerëson përputhshmërinë e veprimtarisë së subjekteve të lejuara me kërkesat ligjore dhe standardet përkatëse.

Irina Argjiri

> *“Çdo dimension i profesionit të farmacistit sjell sfida dhe mundësi për zhvillim.”*

AKKC

Agjencia Kombëtare e
Kontrollit të Cannabis-it

www.nacc.gov.al

info@nacc.gov.al

Rruga "Ibrahim Rugova", 5,
Kati 13, 1001, Tiranë